



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 40 datë 26.10.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR.27, DATË 01.06.2016 “PËR NGRITJEN E
KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ
DHE MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TË PROJEKTEVE
KULTURORE, ARTISTIKE, SPORTIVE DHE RINORE NË BASHKINË
SHKODËR”, TË NDRYSHUAR**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 26.10.2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika, nën-pika 1.1, shkronjat “d”, nenin 25 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr.44/2015“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Vendimit nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave artistiko - kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar, udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko - kulturor”, vendimit nr.71, datë 27.12.2022 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm përfundimtar 2023–2025 të bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë disa ndryshime në VKB nr.27, datë 01.06.2016 “Për ngritjen e këshillit artistiko-kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar, si më poshtë:
 - a. Të miratojë ngritjen e këshillit artistiko-kulturor pranë Bashkisë Shkodër për periudhën dy vjeçare 2023- 2025 të përbërë nga këto anëtar :

| Nr. | Emër Mbiemër | Aktiviteti i tyre në shërbim të artit kulturës dhe sportit |
|-----|-------------------------|--|
| 1 | Amila Gjyrezi | Drejtoreshë, Drejtoresha e kultures arsimit rinise dhe sportit. Eksperte e trashëgimise kulturore dhe artistike. |
| 2 | Zyliha Miloti | Aktore teatri dhe filmi, Mjeshter i Madh. |
| 3 | Pasqualina Gruda | Aktore per artin skenik dhe te kinematografise. |
| 4 | Ridvan Karakaci | Muzikolog dhe kritik arti. |
| 5 | Andi Hila | Piktore, visual art, Profesor ne Departamentin e Arteve, Universiteti Luigj Gurakuqi. |
| 6 | Roland Guli | Kompozitor, Pedagog ne Departamentin e Arteve, universiteti Luigj Gurakuqi. |
| 7 | Arbana Bekteshi (Xhani) | Mjeshtre e Madhe, Mjeshtre e Merituar Sporti (Medalje Arte) Pedagoge ne Universitetin Luigj Gurakuqi. |

- b. Shpërblimi për çdo anëtar të këshillit artistiko-kulturor, do të jetë 4,500 (katërmijë e pesëqind) lekë, çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje, por jo më shume se 6 (gjashtë) mbledhje në vit.
- Pikat e tjera të VKB-së nr.27, datë 01.06.2016, të ndryshuar mbeten në fuqi.
 - Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 - Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ndryshuar.

KRYETAR

Oltion LULI



Sekretari i Këshillit Bashkiak

Denis Lesha

Miratuar me 42 vota

Vota Pro 42

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 30.10.2023